



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 177

Tiranë – E mërkurë, 7 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 56/2020, datë 5.10.2020	Për zgjedhjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve..... 12371
Vendim i Kuvendit nr. 57/2020, datë 5.10.2020	Për zgjedhjen e Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve..... 12371
Vendim i Kuvendit nr. 58/2020, datë 5.10.2020	Për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve..... 12371
Vendim i Kuvendit nr. 59/2020, datë 5.10.2020	Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve..... 12372
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 771, datë 30.9.2020	Për deklarimin pasuri kulturore të “Qendrës historike” të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre..... 12372
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 12, datë 21.9.2020	Për kazeinat dhe kazeinatet të destinuara për konsum njerëzor..... 12388
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 314, datë 25.9.2020	Për delegimin e kompetencave..... 12390
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 531, datë 28.9.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020, “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, të ndryshuar..... 12391
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 537, datë 29.9.2020	Për shfuqizimin e urdhrin nr. 320, datë 15.5.2020, “Për disa kufizime në ofrimin e shërbimeve në bare, restorante dhe lokale, <i>fast-food</i> ”. 12391

**VENDIM
Nr. 56/2020****PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të neneve 13, 181 dhe 183, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në kandidaturat e për zgjedhura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave për Organet Drejtuese të KQZ-së,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ilirjan Celibashi zgjidhet Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 5.10.2020

**VENDIM
Nr. 57/2020****PËR ZGJEDHJEN E
NËNKOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të neneve 14, 181 dhe 183, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në kandidaturat e për zgjedhura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave për Organet Drejtuese të KQZ-së,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Lealba Pelinku zgjidhet Nënkomisionere Shtetërore e Zgjedhjeve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 5.10.2020

**VENDIM
Nr. 58/2020****PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE DHE
KRYETARIT TË KOMISIONIT
RREGULLATOR NË KOMISIONIN
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të neneve 15, 181 dhe 183, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në listën e përbashkët të miraturar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave për Organet Drejtuese të KQZ-së,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është si më poshtë:

- | | |
|-------------------|-----------|
| 1. Ilirjana Nano | kryetare; |
| 2. Dritan Çaka | anëtar; |
| 3. Arens Çela | anëtar; |
| 4. Muharrem Çakaj | anëtar; |
| 5. Helga Vukaj | anëtare. |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 5.10.2020



VENDIM
Nr. 59/2020

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË
KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE NË KOMISIONIN
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të neneve 16, 181 dhe 183, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në listën e përbashkët të miratuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave për Organet Drejtuese të KQZ-së,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhen anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

1. Ilirjan Rusmali
2. Elvin Lako
3. Koli Bele
4. Elvis Çefa
5. Ledio Braho

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.10.2020

VENDIM
Nr. 771, datë 30.9.2020

**PËR DEKLARIMIN PASURI
KULTURORE TË “QENDRËS
HISTORIKE” TË QYTETIT TË
SHKODRËS, PËRCAKTIMIN E ZONËS
MBROJTËSE TË SAJ DHE MIRATIMIN
E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN
DHE ADMINISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 3, shkronjat “a” dhe “ç”, 62, pika 3, dhe 96, pika 1, të ligjit nr. 27/2018,

“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore të “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës dhe përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozim të strukturave të specializuara, të përcaktojë zonat mbrojtëse të monumenteve të kulturës, të ndodhura brenda pasurisë kulturore.

4. Vendimi nr. 1183, datë 5.8.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores Për administrimin e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur, në qytetin e Shkodrës”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e “Qendrës Historike” të qytetit Shkodër dhe të zonës mbrojtëse të saj në Gjeoportalin Kombëtar.

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



**PLANI
PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E “QENDRËS
HISTORIKE” TË QYTETIT TË
SHKODRËS DHE ZONËS MBROJTËSE
TË SAJ**

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës dhe zonës mbrojtëse të saj.

Neni 2
Objekti

Objekti kryesor i këtij plani janë:

a) ruajtja dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit të “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës dhe zonës mbrojtëse të saj, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur;

b) administrimi i “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës dhe zonës mbrojtëse të saj;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të ngarkuara për ruajtjen dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 3
Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Shkodrës përbëhet nga:

- a) “Qendra Historike”;
- b) Zona mbrojtëse.

2. Brenda zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen ansamble arkitektoniko-urbane, monumente kulture të kategorisë I dhe monumente kulture të kategorisë II, zona të gjelbra, sheshe dhe objekte pa status.

3. Plan i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër merr parasysh kufijtë e zonifikimit të “Qendrës Historike”, zonës mbrojtëse të saj, si dhe rregullat për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

4. Organet e njërive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e “Qendrës Historike”, zonës mbrojtëse të saj dhe monumenteve të kulturës, të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

Neni 4
“Qendra Historike” dhe kufijtë e saj

1. “Qendra Historike” është hapësira urbane që ruan në tërësinë e saj vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit, në të cilat dokumentohen rruga e zhvillimit historik të qytetit dhe arritjet arkitektoniko-urbanistike. Pjesë përbërëse e saj janë ndërtesat, së bashku me elementet urbane përreth, si rrugët, trotualet, muret rrethuese, portat, oborret, si dhe strukturat e ndriçimit, dekorit, gjelbërimi.

2. Hapësira urbane e “Qendrës Historike” në qytetin e Shkodrës përfshin:

a) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “28 Nëntori” (kufizuar në J-P me rrugën “13 Dhjetori” dhe në V-L me sheshin e qytetit);

b) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Kol Idromeno” (kufizuar në J-P me sheshin e qytetit dhe në V-L me sheshin “Dugajet e Reja”);

c) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Gjuhadol” krahu verior (kufizuar në V-P me rrugën “Kol Idromeno” dhe në J-L me rrugën “Marin Beçikemi”);

ç) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “At Gjergj Fishta” (kufizuar në V-L me Hotel Kolosseo dhe në J-P me rrugën “Gjuhadol”).

3. Në “Qendrën Historike” ndodhen pasuri kulturore të paluajtshme si monumente kulture të kategorisë I dhe II dhe objekte pa status.

4. Kufijtë e “Qendrës Historike” paraqiten në hartën e zonifikimit e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

5. Koordinatat gjeografike të “Qendrës Historike” paraqiten në aneksin 1, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5
Zona mbrojtëse dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse përreth “Qendrës Historike” ruan vlera të trashëgimisë kulturore, historike,



urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit, duke plotësuar vlerat e “Qendrës Historike”.

2. Zona mbrojtëse me vlerën e saj plotësuese luan një rol me rëndësi në mbrojtjen e vlerave dhe në krijimin gradual të zhvillimeve në territor nga “Qendra Historike” në zonën e lirë.

3. Hapësira urbane e zonës mbrojtëse të “Qendrës Historike” në qytetin e Shkodrës përfshin:

a) ansamblin arkitektoniko-urbanistik midis rrugës “Kol Idromeno” dhe rrugëve “Hasan Riza Pasha” dhe “Fushë Çelë”;

b) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Ludovik Saraçi”;

c) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Gurazezëve”;

ç) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Gurakuqëve”;

d) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Murgeshave”;

dh) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës “Ndre Mjeda”;

e) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës pas Kafes së Madhe;

ë) ansamblin arkitektoniko-urbanistik të rrugës pas “13 Dhjetori”.

4. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

5. Koordinatat gjeografike të zonës mbrojtëse paraqiten në aneksin 2, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6

Ndërhryrjet e lejuara në “Qendrën Historike”

1. Ndërhryrjet në “Qendrën Historike” kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit të qytetit të Shkodrës.

2. Brenda kësaj zone lejohen këto ndërhryrje:

a) ndërhryrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;

b) ndërhryrje restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistike-arkitektonike, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë duke përfshirë të gjithë kanalizimet e vjetra të zbuluara ose që do të zbulohen, si dhe duke ruajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave dhe shesheve publike;

c) rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese;

ç) rehabilitimi i hapësirave dhe plotësimi i sipërfaqeve të reja të cilat ndikojnë në vlerat dhe unitetin kompozicional të ansamblit arkitektoniko-urbanistik;

d) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 7

Ndërhryrjet e lejuara në monumentet e kulturës

1. Ndërhryrjet në monumentet e kulturës dhe zonën mbrojtëse të tyre, të cilat ndodhen në “Qendrën Historike” dhe zonën mbrojtëse, kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

2. Brenda kësaj zone lejohen:

a) ndërhryrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;

b) rrijetëzime, me kusht që projekti i rrijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 8

Ndërhryrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të “Qendrës Historike”

Ndërhryrjet e lejuara brenda zonës mbrojtëse janë:

a) restaurime, rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese;

b) rikonstruksione dhe ndërtime të reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore;

c) ndërtime të reja, shtesa dhe përshtatje në sheshe të lira, në harmoni me karakteristikat e “Qendrës Historike”.



Neni 9

**Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e
“Qendrës Historike” dhe zonës mbrojtëse
të saj**

1. Në hapësirën e “Qendrës Historike” dhe zonës mbrojtëse të saj nuk lejohen ndërtimet e reja që prekin monumentet e kulturës dhe zonat mbrojtëse të tyre.

2. Në zonën mbrojtëse të “Qendrës Historike” nuk lejohen ndërtimet me karakter industrial, me përjashtim të punishteve të artizanatit.

Neni 10

**Kriteret e projektimit për rikonstruksione,
ndërhyrjet e lejuara në “Qendrën Historike”,
monumentet e kulturës dhe zonës mbrojtëse
të tyre**

1. Projektet për konservimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen në “Qendrën Historike” dhe monumentet e kulturës hartohen në varësi të vlerave historike-kulturore të objektit apo monumentit për të cilët janë shpallur pasuri kulturore, si dhe në kriteret për konservim e restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim.

2. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese brenda “Qendrës Historike” hartohen në bazë të studimeve urbanistike dhe arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në këtë zonë;

b) duke respektuar raportet urbanistike e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke ruajtur sa të jetë e mundur karakteristikat origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale;

d) duke u bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese, brenda zonës mbrojtëse hartohen bazuar në Planin e Detajuar Vendor të

Bashkisë Shkodër apo studimet urbanistike e arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në këtë zonë;

b) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore.

4. Rehabilitimi i hapësirave dhe plotësimet në sipërfaqet e lira brenda “Qendrës Historike” kryhen vetëm në ato territore, në të cilat leja e ndërtimit nuk bie ndesh me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, këtë plan dhe legjislacionin në fuqi për planifikimin e zhvillimin e territorit dhe rregullat e tjera në fuqi:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave ekzistuese brenda “Qendrës Historike”. Nga pikëpamja arkitekturore ato duhet të jenë në harmoni me këto banesa, duke respektuar përpjesëtimet urbanistike e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike, si dhe altimetrinë përgjatë rrugëve kryesore, por:

i. jo më shumë se 10 m nga kuota e terrenit deri në kornizën e çatisë, për çati të pashfrytëzueshme;

ii. jo më shumë se 10 m nga kuota e terrenit deri në kulmin e çatisë, për çati të shfrytëzueshme;

b) duke respektuar përpjesëtimet urbanistike e vëllimore të treguesve zhvillimor parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër;

c) duke respektuar tipologjinë e ndërtimeve në atë zonë lidhur me kompozimin planimetrik dhe planvendosjen në sheshin e ndërtimit;

ç) ruajtur kuotën e dyshemesë së katit përdhe, që mos të kalojë 50 cm nga niveli i truallit të rrugës;

d) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çative për ndërtimet e reja, veshja të jetë me tjegulla vendi qeramike, pjerrësia pa kaluar 25 gradë, pajisur me ulluk; në rastet kur është e mundur, çatia mund të jetë e shfrytëzueshme;

dh) përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dierve dhe dritareve, ngjyrën e fasadës së banesës/objektit, si dhe materialin e mureve rrethuese, lartësinë dhe ngjyrat e tyre në harmoni me karakteristikat e “Qendrës Historike”.

5. Projektet për ndërtimet e reja, shtesat dhe



përshtatjet në sheshe të lira brenda zonës mbrojtëse hartohen vetëm në ato terriore, në të cilat leja e ndërtimit nuk bie ndesh me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, këtë plan, ligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin e terriorit” dhe rregulla të tjera në fuqi:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në zonën mbrojtëse të “Qendrës Historike”;

b) duke respektuar përpjesëtimet urbanistike e vëllimore të treguesve zhvillimor parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër;

c) duke respektuar tipologjinë e ndërtimeve në atë zonë lidhur me kompozimin planimetrik dhe planvendosjen në sheshin e ndërtimit;

ç) duke ruajtur kufizimin që lartësia e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet të kalojë lartësinë maksimale 12 m deri në kornizën e çatisë;

d) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çative të ndërtimeve të reja, në rastet e mbulesave me çati, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës mbrojtëse;

dh) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dymve dhe dritareve, si dhe ngjyrën e fasadës së banesës/objektit, në harmoni me peizazhin kulturor të Zonës Mbrojtëse.

6. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në tërësinë e “Qendrës Historike” dhe zonës mbrojtëse të saj hartohen:

a) bazuar në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në “Qendrën Historike”, monumentet e kulturës të veçanta dhe zonës mbrojtëse të saj

1. Studimet për vlerësimin e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese në “Qendrën Historike” dhe zonën mbrojtëse të saj, duke përfshirë banesat, fasadat e tyre, muret rrethuese,

trotuaret, kalldrëmet tradicionale dhe elemente të tjera urbanistiko-arkitektonike, dhe monumenteve të kulturës hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Shkodër ose/dhe nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimit dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Projektet për konservimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen në “Qendrën Historike” dhe monumentet e kulturës hartohen nga IKTK-ja, DRTK Shkodër ose/dhe nga subjekte të licencuara për projektim në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK Shkodër ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese, rehabilitimin e hapësirave dhe plotësimi i sipërfaqeve të lira në “Qendrën Historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK Shkodër ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e terriorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga DRTK Shkodër ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese, dhe ndërtimet e reja në Zonën Mbrojtëse hartohen nga IKTK-ja, DRTK Shkodër ose nga subjekte të licencuar për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e terriorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit, kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK Shkodër.

5. Projektet për rikonstruksionin e rrjetit rrugor dhe shesheve në “Qendrën Historike”



dhe zonën mbrojtëse të saj hartohen nga IKTK-ja, DRTK Shkodër ose/dhe nga subjekte të licencuara për projektim në fushën e restaurimit dhe projektet për realizimin e linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore hartohen nga subjekte të licencuara sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK Shkodër ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit dhe sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve kryhet sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimit e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në “Qendrën Historike” dhe monumentet e kulturës shqyrtohen nga ministria përgjegjëse për


trashëgiminë kulturore, IKTK-ja, DRTK Shkodër dhe miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në rastet kur projekti parashikon ndërhyrje në pasuritë kulturore, hartimi bëhet nga subjekte të licencuara për projektim në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK Shkodër.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Këtij plani i bashkëngjitet zonifikimi i “Qendrës Historike”, zonës mbrojtëse të saj dhe tabelat përkatëse të koordinatave gjeografike.





ANEKSI 1

Kordinatat e Qendrës Historike, Shkodër
WGS. 84

Nr.	Long.	Lat.
Sh1	19° 30' 46.420" E	42° 3' 57.805" N
Sh2	19° 30' 46.292" E	42° 3' 57.846" N
Sh3	19° 30' 45.951" E	42° 3' 57.333" N
Sh4	19° 30' 45.810" E	42° 3' 57.070" N
Sh5	19° 30' 45.583" E	42° 3' 57.115" N
Sh6	19° 30' 45.536" E	42° 3' 56.987" N
Sh7	19° 30' 45.218" E	42° 3' 57.024" N
Sh8	19° 30' 44.841" E	42° 3' 56.413" N
Sh9	19° 30' 45.072" E	42° 3' 56.338" N
Sh10	19° 30' 44.791" E	42° 3' 56.108" N
Sh11	19° 30' 44.652" E	42° 3' 55.988" N
Sh12	19° 30' 44.519" E	42° 3' 56.095" N
Sh13	19° 30' 44.365" E	42° 3' 56.018" N
Sh14	19° 30' 44.634" E	42° 3' 55.780" N
Sh15	19° 30' 44.483" E	42° 3' 55.653" N
Sh16	19° 30' 44.511" E	42° 3' 55.623" N
Sh17	19° 30' 44.395" E	42° 3' 55.527" N
Sh18	19° 30' 44.441" E	42° 3' 55.501" N
Sh19	19° 30' 44.344" E	42° 3' 55.427" N
Sh20	19° 30' 44.196" E	42° 3' 55.314" N
Sh21	19° 30' 44.112" E	42° 3' 55.380" N
Sh22	19° 30' 44.019" E	42° 3' 55.306" N
Sh23	19° 30' 43.796" E	42° 3' 55.103" N
Sh24	19° 30' 43.515" E	42° 3' 54.860" N
Sh25	19° 30' 43.080" E	42° 3' 54.481" N
Sh26	19° 30' 42.868" E	42° 3' 54.336" N
Sh27	19° 30' 43.019" E	42° 3' 54.137" N
Sh28	19° 30' 43.411" E	42° 3' 53.662" N
Sh29	19° 30' 43.517" E	42° 3' 53.583" N
Sh30	19° 30' 43.659" E	42° 3' 53.731" N
Sh31	19° 30' 44.029" E	42° 3' 53.954" N
Sh32	19° 30' 44.070" E	42° 3' 53.923" N
Sh33	19° 30' 44.078" E	42° 3' 53.891" N
Sh34	19° 30' 44.304" E	42° 3' 53.667" N
Sh35	19° 30' 44.288" E	42° 3' 53.621" N
Sh36	19° 30' 44.460" E	42° 3' 53.458" N
Sh37	19° 30' 44.522" E	42° 3' 53.442" N
Sh38	19° 30' 44.584" E	42° 3' 53.371" N
Sh39	19° 30' 44.631" E	42° 3' 53.376" N
Sh40	19° 30' 44.725" E	42° 3' 53.267" N
Sh41	19° 30' 45.104" E	42° 3' 53.496" N
Sh42	19° 30' 45.465" E	42° 3' 53.688" N
Sh43	19° 30' 45.166" E	42° 3' 54.064" N
Sh44	19° 30' 46.027" E	42° 3' 54.457" N

Sh45	19° 30' 46.003" E	42° 3' 54.565" N
Sh46	19° 30' 45.838" E	42° 3' 54.745" N
Sh47	19° 30' 45.811" E	42° 3' 54.854" N
Sh48	19° 30' 45.663" E	42° 3' 54.985" N
Sh49	19° 30' 45.959" E	42° 3' 55.217" N
Sh50	19° 30' 46.041" E	42° 3' 55.167" N
Sh51	19° 30' 46.101" E	42° 3' 55.238" N
Sh52	19° 30' 46.047" E	42° 3' 55.299" N
Sh53	19° 30' 46.385" E	42° 3' 55.741" N
Sh54	19° 30' 47.053" E	42° 3' 55.633" N
Sh55	19° 30' 47.220" E	42° 3' 55.699" N
Sh56	19° 30' 47.351" E	42° 3' 55.767" N
Sh57	19° 30' 47.387" E	42° 3' 55.803" N
Sh58	19° 30' 47.402" E	42° 3' 55.862" N
Sh59	19° 30' 47.422" E	42° 3' 55.880" N
Sh60	19° 30' 47.518" E	42° 3' 55.933" N
Sh61	19° 30' 47.754" E	42° 3' 56.032" N
Sh62	19° 30' 47.757" E	42° 3' 56.052" N
Sh63	19° 30' 47.473" E	42° 3' 56.473" N
Sh64	19° 30' 47.656" E	42° 3' 56.560" N
Sh65	19° 30' 48.307" E	42° 3' 57.189" N
Sh66	19° 30' 48.790" E	42° 3' 56.548" N
Sh67	19° 30' 48.887" E	42° 3' 56.590" N
Sh68	19° 30' 48.638" E	42° 3' 56.970" N
Sh69	19° 30' 48.865" E	42° 3' 57.084" N
Sh70	19° 30' 48.833" E	42° 3' 57.129" N
Sh71	19° 30' 49.016" E	42° 3' 57.220" N
Sh72	19° 30' 48.765" E	42° 3' 57.517" N
Sh73	19° 30' 48.799" E	42° 3' 57.533" N
Sh74	19° 30' 48.712" E	42° 3' 57.630" N
Sh75	19° 30' 48.673" E	42° 3' 57.614" N
Sh76	19° 30' 48.417" E	42° 3' 57.900" N
Sh77	19° 30' 48.488" E	42° 3' 57.978" N
Sh78	19° 30' 48.607" E	42° 3' 57.899" N
Sh79	19° 30' 48.719" E	42° 3' 57.986" N
Sh80	19° 30' 48.841" E	42° 3' 57.878" N
Sh81	19° 30' 48.946" E	42° 3' 57.952" N
Sh82	19° 30' 49.037" E	42° 3' 58.014" N
Sh83	19° 30' 48.932" E	42° 3' 58.129" N
Sh84	19° 30' 49.570" E	42° 3' 58.868" N
Sh85	19° 30' 49.180" E	42° 3' 59.312" N
Sh86	19° 30' 48.727" E	42° 3' 59.531" N
Sh87	19° 30' 48.495" E	42° 3' 59.628" N
Sh88	19° 30' 48.835" E	42° 4' 0.089" N
Sh89	19° 30' 48.849" E	42° 4' 0.142" N
Sh90	19° 30' 48.851" E	42° 4' 0.197" N
Sh91	19° 30' 48.841" E	42° 4' 0.250" N
Sh92	19° 30' 48.820" E	42° 4' 0.303" N
Sh93	19° 30' 48.788" E	42° 4' 0.351" N
Sh94	19° 30' 48.746" E	42° 4' 0.396" N



Sh95	19° 30' 48.694" E	42° 4' 0.435" N
Sh96	19° 30' 48.636" E	42° 4' 0.467" N
Sh97	19° 30' 48.571" E	42° 4' 0.491" N
Sh98	19° 30' 48.501" E	42° 4' 0.508" N
Sh99	19° 30' 47.666" E	42° 4' 0.236" N
Sh100	19° 30' 47.191" E	42° 4' 0.085" N
Sh101	19° 30' 47.284" E	42° 3' 59.895" N
Sh102	19° 30' 47.236" E	42° 3' 59.654" N
Sh103	19° 30' 47.504" E	42° 3' 59.534" N
Sh104	19° 30' 47.390" E	42° 3' 59.408" N
Sh105	19° 30' 47.492" E	42° 3' 59.363" N
Sh106	19° 30' 47.458" E	42° 3' 59.306" N
Sh107	19° 30' 47.502" E	42° 3' 59.287" N
Sh108	19° 30' 47.536" E	42° 3' 59.215" N
Sh109	19° 30' 47.454" E	42° 3' 59.119" N
Sh110	19° 30' 47.331" E	42° 3' 59.089" N
Sh111	19° 30' 47.344" E	42° 3' 59.081" N
Sh112	19° 30' 46.448" E	42° 3' 57.853" N
Sh113	19° 31' 1.199" E	42° 4' 10.335" N
Sh114	19° 31' 1.102" E	42° 4' 9.953" N
Sh115	19° 31' 1.048" E	42° 4' 9.981" N
Sh116	19° 31' 0.675" E	42° 4' 9.605" N
Sh117	19° 31' 0.272" E	42° 4' 9.252" N
Sh118	19° 31' 0.259" E	42° 4' 9.262" N
Sh119	19° 30' 59.690" E	42° 4' 8.902" N
Sh120	19° 30' 59.637" E	42° 4' 8.967" N
Sh121	19° 30' 59.426" E	42° 4' 8.819" N
Sh122	19° 30' 59.516" E	42° 4' 8.735" N
Sh123	19° 30' 59.299" E	42° 4' 8.606" N
Sh124	19° 30' 59.260" E	42° 4' 8.634" N
Sh125	19° 30' 59.020" E	42° 4' 8.509" N
Sh126	19° 30' 58.981" E	42° 4' 8.544" N
Sh127	19° 30' 58.820" E	42° 4' 8.450" N
Sh128	19° 30' 58.839" E	42° 4' 8.419" N
Sh129	19° 30' 58.498" E	42° 4' 8.253" N
Sh130	19° 30' 58.465" E	42° 4' 8.165" N
Sh131	19° 30' 57.530" E	42° 4' 7.669" N
Sh132	19° 30' 57.390" E	42° 4' 7.818" N
Sh133	19° 30' 57.277" E	42° 4' 7.759" N
Sh134	19° 30' 57.144" E	42° 4' 7.689" N
Sh135	19° 30' 57.231" E	42° 4' 7.601" N
Sh136	19° 30' 56.269" E	42° 4' 7.203" N
Sh137	19° 30' 56.323" E	42° 4' 7.141" N
Sh138	19° 30' 55.934" E	42° 4' 6.934" N
Sh139	19° 30' 55.985" E	42° 4' 6.871" N
Sh140	19° 30' 55.672" E	42° 4' 6.720" N
Sh141	19° 30' 55.344" E	42° 4' 7.087" N
Sh142	19° 30' 55.246" E	42° 4' 7.028" N
Sh143	19° 30' 55.269" E	42° 4' 7.000" N
Sh144	19° 30' 55.141" E	42° 4' 6.927" N

Sh145	19° 30' 55.067" E	42° 4' 7.002" N
Sh146	19° 30' 54.721" E	42° 4' 6.809" N
Sh147	19° 30' 54.958" E	42° 4' 6.570" N
Sh148	19° 30' 54.654" E	42° 4' 6.422" N
Sh149	19° 30' 54.915" E	42° 4' 6.110" N
Sh150	19° 30' 54.489" E	42° 4' 5.907" N
Sh151	19° 30' 54.274" E	42° 4' 6.155" N
Sh152	19° 30' 54.221" E	42° 4' 6.141" N
Sh153	19° 30' 54.065" E	42° 4' 6.289" N
Sh154	19° 30' 53.984" E	42° 4' 6.151" N
Sh155	19° 30' 54.043" E	42° 4' 6.090" N
Sh156	19° 30' 53.922" E	42° 4' 6.026" N
Sh157	19° 30' 53.995" E	42° 4' 5.960" N
Sh158	19° 30' 53.679" E	42° 4' 5.780" N
Sh159	19° 30' 53.500" E	42° 4' 5.760" N
Sh160	19° 30' 53.216" E	42° 4' 5.599" N
Sh161	19° 30' 53.266" E	42° 4' 5.543" N
Sh162	19° 30' 53.319" E	42° 4' 5.573" N
Sh163	19° 30' 53.385" E	42° 4' 5.507" N
Sh164	19° 30' 53.073" E	42° 4' 5.329" N
Sh165	19° 30' 52.879" E	42° 4' 5.443" N
Sh166	19° 30' 52.767" E	42° 4' 5.367" N
Sh167	19° 30' 52.573" E	42° 4' 5.476" N
Sh168	19° 30' 52.374" E	42° 4' 5.351" N
Sh169	19° 30' 53.075" E	42° 4' 4.906" N
Sh170	19° 30' 53.193" E	42° 4' 4.791" N
Sh171	19° 30' 52.990" E	42° 4' 4.657" N
Sh172	19° 30' 52.963" E	42° 4' 4.622" N
Sh173	19° 30' 52.232" E	42° 4' 4.080" N
Sh174	19° 30' 52.781" E	42° 4' 3.879" N
Sh175	19° 30' 52.908" E	42° 4' 3.803" N
Sh176	19° 30' 52.887" E	42° 4' 3.785" N
Sh177	19° 30' 53.358" E	42° 4' 3.519" N
Sh178	19° 30' 53.438" E	42° 4' 3.621" N
Sh179	19° 30' 53.403" E	42° 4' 3.640" N
Sh180	19° 30' 53.570" E	42° 4' 3.825" N
Sh181	19° 30' 53.772" E	42° 4' 3.892" N
Sh182	19° 30' 53.911" E	42° 4' 4.023" N
Sh183	19° 30' 53.858" E	42° 4' 4.103" N
Sh184	19° 30' 53.880" E	42° 4' 4.120" N
Sh185	19° 30' 53.811" E	42° 4' 4.190" N
Sh186	19° 30' 54.434" E	42° 4' 4.569" N
Sh187	19° 30' 54.510" E	42° 4' 4.664" N
Sh188	19° 30' 55.047" E	42° 4' 4.934" N
Sh189	19° 30' 55.263" E	42° 4' 4.744" N
Sh190	19° 30' 55.343" E	42° 4' 4.782" N
Sh191	19° 30' 55.281" E	42° 4' 4.851" N
Sh192	19° 30' 55.422" E	42° 4' 4.941" N
Sh193	19° 30' 55.360" E	42° 4' 5.016" N
Sh194	19° 30' 55.317" E	42° 4' 4.992" N



Sh195	19° 30' 55.267" E	42° 4' 5.056" N
Sh196	19° 30' 55.448" E	42° 4' 5.144" N
Sh197	19° 30' 55.459" E	42° 4' 5.132" N
Sh198	19° 30' 55.613" E	42° 4' 5.209" N
Sh199	19° 30' 55.875" E	42° 4' 5.388" N
Sh200	19° 30' 55.779" E	42° 4' 5.479" N
Sh201	19° 30' 56.320" E	42° 4' 5.757" N
Sh202	19° 30' 56.582" E	42° 4' 5.473" N
Sh203	19° 30' 56.733" E	42° 4' 5.554" N
Sh204	19° 30' 56.702" E	42° 4' 5.587" N
Sh205	19° 30' 56.999" E	42° 4' 5.759" N
Sh206	19° 30' 57.103" E	42° 4' 5.676" N
Sh207	19° 30' 57.179" E	42° 4' 5.721" N
Sh208	19° 30' 56.863" E	42° 4' 6.079" N
Sh209	19° 30' 57.465" E	42° 4' 6.434" N
Sh210	19° 30' 57.508" E	42° 4' 6.459" N
Sh211	19° 30' 57.603" E	42° 4' 6.335" N
Sh212	19° 30' 57.650" E	42° 4' 6.354" N
Sh213	19° 30' 57.890" E	42° 4' 6.057" N
Sh214	19° 30' 57.876" E	42° 4' 6.051" N
Sh215	19° 30' 57.954" E	42° 4' 5.955" N
Sh216	19° 30' 58.008" E	42° 4' 5.980" N
Sh217	19° 30' 57.942" E	42° 4' 6.062" N
Sh218	19° 30' 58.238" E	42° 4' 6.195" N
Sh219	19° 30' 58.221" E	42° 4' 6.215" N
Sh220	19° 30' 58.355" E	42° 4' 6.283" N
Sh221	19° 30' 58.321" E	42° 4' 6.326" N
Sh222	19° 30' 58.289" E	42° 4' 6.366" N
Sh223	19° 30' 58.343" E	42° 4' 6.385" N
Sh224	19° 30' 58.081" E	42° 4' 6.730" N
Sh225	19° 30' 58.293" E	42° 4' 6.843" N
Sh226	19° 30' 58.352" E	42° 4' 6.790" N
Sh227	19° 30' 58.594" E	42° 4' 6.915" N
Sh228	19° 30' 58.541" E	42° 4' 6.968" N
Sh229	19° 30' 58.788" E	42° 4' 7.102" N
Sh230	19° 30' 58.909" E	42° 4' 6.937" N
Sh231	19° 30' 59.772" E	42° 4' 7.349" N
Sh232	19° 31' 0.266" E	42° 4' 7.548" N
Sh233	19° 31' 0.778" E	42° 4' 7.686" N
Sh234	19° 31' 0.847" E	42° 4' 7.479" N
Sh235	19° 31' 0.875" E	42° 4' 7.142" N
Sh236	19° 31' 0.894" E	42° 4' 6.971" N
Sh237	19° 31' 0.937" E	42° 4' 6.973" N
Sh238	19° 31' 0.939" E	42° 4' 6.804" N
Sh239	19° 31' 0.899" E	42° 4' 6.549" N
Sh240	19° 31' 0.932" E	42° 4' 6.363" N
Sh241	19° 31' 0.807" E	42° 4' 6.315" N
Sh242	19° 31' 0.979" E	42° 4' 5.919" N
Sh243	19° 31' 1.039" E	42° 4' 5.709" N
Sh244	19° 31' 0.889" E	42° 4' 5.682" N

Sh245	19° 31' 0.920" E	42° 4' 5.584" N
Sh246	19° 31' 1.069" E	42° 4' 5.607" N
Sh247	19° 31' 1.144" E	42° 4' 5.346" N
Sh248	19° 31' 0.986" E	42° 4' 5.292" N
Sh249	19° 31' 1.081" E	42° 4' 5.184" N
Sh250	19° 31' 1.501" E	42° 4' 4.704" N
Sh251	19° 31' 1.497" E	42° 4' 4.685" N
Sh252	19° 31' 1.723" E	42° 4' 4.705" N
Sh253	19° 31' 2.058" E	42° 4' 4.238" N
Sh254	19° 31' 1.974" E	42° 4' 4.192" N
Sh255	19° 31' 2.122" E	42° 4' 3.888" N
Sh256	19° 31' 2.293" E	42° 4' 3.979" N
Sh257	19° 31' 2.417" E	42° 4' 3.827" N
Sh258	19° 31' 2.493" E	42° 4' 3.735" N
Sh259	19° 31' 2.247" E	42° 4' 3.591" N
Sh260	19° 31' 2.533" E	42° 4' 3.275" N
Sh261	19° 31' 2.705" E	42° 4' 3.351" N
Sh262	19° 31' 2.825" E	42° 4' 3.194" N
Sh263	19° 31' 2.470" E	42° 4' 3.041" N
Sh264	19° 31' 2.691" E	42° 4' 2.845" N
Sh265	19° 31' 2.944" E	42° 4' 2.953" N
Sh266	19° 31' 3.060" E	42° 4' 2.701" N
Sh267	19° 31' 2.947" E	42° 4' 2.635" N
Sh268	19° 31' 3.020" E	42° 4' 2.555" N
Sh269	19° 31' 2.964" E	42° 4' 2.511" N
Sh270	19° 31' 3.052" E	42° 4' 2.436" N
Sh271	19° 31' 3.046" E	42° 4' 2.305" N
Sh272	19° 31' 3.149" E	42° 4' 2.048" N
Sh273	19° 31' 3.205" E	42° 4' 1.908" N
Sh274	19° 31' 2.950" E	42° 4' 1.830" N
Sh275	19° 31' 2.943" E	42° 4' 1.801" N
Sh276	19° 31' 3.318" E	42° 4' 1.601" N
Sh277	19° 31' 3.286" E	42° 4' 1.436" N
Sh278	19° 31' 3.047" E	42° 4' 1.323" N
Sh279	19° 31' 2.872" E	42° 4' 1.225" N
Sh280	19° 31' 2.592" E	42° 4' 1.055" N
Sh281	19° 31' 2.313" E	42° 4' 0.929" N
Sh282	19° 31' 2.207" E	42° 4' 0.999" N
Sh283	19° 31' 2.079" E	42° 4' 0.901" N
Sh284	19° 31' 1.915" E	42° 4' 0.859" N
Sh285	19° 31' 1.721" E	42° 4' 1.024" N
Sh286	19° 31' 1.601" E	42° 4' 1.077" N
Sh287	19° 31' 1.512" E	42° 4' 1.002" N
Sh288	19° 31' 1.091" E	42° 4' 1.238" N
Sh289	19° 31' 1.415" E	42° 4' 1.539" N
Sh290	19° 31' 1.036" E	42° 4' 1.759" N
Sh291	19° 31' 0.339" E	42° 4' 1.948" N
Sh292	19° 30' 59.837" E	42° 4' 2.195" N
Sh293	19° 31' 0.215" E	42° 4' 2.522" N
Sh294	19° 30' 58.866" E	42° 4' 3.297" N



Sh295	19° 30' 58.792" E	42° 4' 3.340" N
Sh296	19° 30' 58.712" E	42° 4' 3.533" N
Sh297	19° 30' 58.683" E	42° 4' 3.526" N
Sh298	19° 30' 58.667" E	42° 4' 3.631" N
Sh299	19° 30' 58.528" E	42° 4' 3.706" N
Sh300	19° 30' 58.386" E	42° 4' 3.815" N
Sh301	19° 30' 58.352" E	42° 4' 4.024" N
Sh302	19° 30' 57.939" E	42° 4' 4.454" N
Sh303	19° 30' 57.607" E	42° 4' 4.302" N
Sh304	19° 30' 57.507" E	42° 4' 4.257" N
Sh305	19° 30' 57.520" E	42° 4' 4.231" N
Sh306	19° 30' 56.982" E	42° 4' 4.045" N
Sh307	19° 30' 56.955" E	42° 4' 4.074" N
Sh308	19° 30' 56.310" E	42° 4' 3.853" N
Sh309	19° 30' 56.335" E	42° 4' 3.805" N
Sh310	19° 30' 56.202" E	42° 4' 3.767" N
Sh311	19° 30' 56.167" E	42° 4' 3.814" N
Sh312	19° 30' 56.065" E	42° 4' 3.781" N
Sh313	19° 30' 55.945" E	42° 4' 4.029" N
Sh314	19° 30' 55.127" E	42° 4' 3.836" N
Sh315	19° 30' 55.085" E	42° 4' 3.929" N
Sh316	19° 30' 54.888" E	42° 4' 3.886" N
Sh317	19° 30' 54.930" E	42° 4' 3.791" N
Sh318	19° 30' 54.520" E	42° 4' 3.687" N
Sh319	19° 30' 54.557" E	42° 4' 3.599" N
Sh320	19° 30' 54.754" E	42° 4' 3.656" N
Sh321	19° 30' 54.841" E	42° 4' 3.420" N
Sh322	19° 30' 54.456" E	42° 4' 3.389" N
Sh323	19° 30' 54.172" E	42° 4' 3.326" N
Sh324	19° 30' 53.621" E	42° 4' 3.163" N
Sh325	19° 30' 53.612" E	42° 4' 3.113" N
Sh326	19° 30' 53.717" E	42° 4' 2.956" N
Sh327	19° 30' 53.339" E	42° 4' 2.746" N
Sh328	19° 30' 53.134" E	42° 4' 2.603" N
Sh329	19° 30' 52.987" E	42° 4' 2.544" N
Sh330	19° 30' 53.011" E	42° 4' 2.475" N
Sh331	19° 30' 52.957" E	42° 4' 2.447" N
Sh332	19° 30' 52.901" E	42° 4' 2.505" N
Sh333	19° 30' 52.848" E	42° 4' 2.512" N
Sh334	19° 30' 52.760" E	42° 4' 2.468" N
Sh335	19° 30' 52.726" E	42° 4' 2.510" N
Sh336	19° 30' 52.377" E	42° 4' 2.300" N
Sh337	19° 30' 52.455" E	42° 4' 2.244" N
Sh338	19° 30' 52.544" E	42° 4' 2.198" N
Sh339	19° 30' 52.641" E	42° 4' 2.162" N
Sh340	19° 30' 52.744" E	42° 4' 2.137" N
Sh341	19° 30' 52.850" E	42° 4' 2.124" N
Sh342	19° 30' 52.958" E	42° 4' 2.123" N
Sh343	19° 30' 53.260" E	42° 4' 2.190" N
Sh344	19° 30' 54.042" E	42° 4' 2.362" N

Sh345	19° 30' 54.617" E	42° 4' 2.472" N
Sh346	19° 30' 55.176" E	42° 4' 2.281" N
Sh347	19° 30' 55.227" E	42° 4' 2.165" N
Sh348	19° 30' 55.333" E	42° 4' 2.124" N
Sh349	19° 30' 56.561" E	42° 4' 2.395" N
Sh350	19° 30' 57.213" E	42° 4' 2.280" N
Sh351	19° 30' 58.430" E	42° 4' 2.069" N
Sh352	19° 30' 59.275" E	42° 4' 1.641" N
Sh353	19° 31' 2.024" E	42° 4' 0.316" N
Sh354	19° 31' 2.360" E	42° 4' 0.439" N
Sh355	19° 31' 2.736" E	42° 4' 0.608" N
Sh356	19° 31' 2.833" E	42° 4' 0.529" N
Sh357	19° 31' 2.892" E	42° 4' 0.474" N
Sh358	19° 31' 3.021" E	42° 4' 0.370" N
Sh359	19° 31' 3.068" E	42° 4' 0.391" N
Sh360	19° 31' 3.111" E	42° 4' 0.332" N
Sh361	19° 31' 3.168" E	42° 4' 0.349" N
Sh362	19° 31' 3.292" E	42° 4' 0.154" N
Sh363	19° 31' 3.259" E	42° 4' 0.144" N
Sh364	19° 31' 3.383" E	42° 4' 0.000" N
Sh365	19° 31' 3.541" E	42° 4' 0.046" N
Sh366	19° 31' 3.753" E	42° 3' 59.630" N
Sh367	19° 31' 3.918" E	42° 3' 59.525" N
Sh368	19° 31' 4.024" E	42° 3' 59.498" N
Sh369	19° 31' 4.074" E	42° 3' 59.523" N
